

Ajni Sinani

DEKLARATA ISLAME DHE KONVETA EVROPIANE

TË DREJTAT E NJERIUT *

"O njerëz! Ne ju kemi krijuar juve prej një mashkulli dhe një femre dhe u kemi bërë popuj e fise që t'a njihni njëri-tjetrin. Më fisniku tek All-llahu është ai i cili më së shumti i ruhet Atij..." (Kur'ani, 49- 13)

"Njerëzit janë të harabartë si dhëmbët në krahrin e endësit, nuk ka përparësi të të bardhit ndaj të ziut e as të arabit ndaj joarabit." (Muhammedi a.s.)

Natyra njerëzore, njeriut, i është dhuruar nga Zoti. Njeriu lind i lirë, por gjithkund është në pranga.

Islami, ka parashtruar të drejta themelore universale, për të gjithë njerëzimin. Qysh para 14 shekujsh, Islami, të drejtat e njeriut i ka sanksionuar me ligj dhe ka siguruar mbrojtjen e tyre. Këto të drejta, Islami i ka parashtruar, si të drejta themelore për çdo njeri, pa marrë parasysh gjendjen dhe pozitën e tij shoqërore. Këto të drejta janë të patjetërsueshme.

Për të kuptuar largpamësinë e të drejtave në Islam, është e nevojshme të theksojmë se të drejtat e njeriut në Islam janë pjesë përbërëse e vizionit integral që muslimani ka në raport me All-llahun, universin dhe njeriun.

Kur flasim për të drejtat e njeriut në Islam, atëhere, nënkuptojmë ato të drejta, që janë të dhëna nga Zoti vetë. Të drejtat e dhëna nga mbretërit ose kuvendet ligjvënëse, mund të flaken, ashtu sikurse edhe janë miratuar, ndërkaq, asnjë individ dhe asnjë institucion, nuk mund t'i hedhë poshtë të drejtat, që janë dhënë nga Zoti. Kartat, proklamatat dhe rezolutat e aprovuara, nuk mund të krahasohen me të

* Ku punim është nxjerrë nga nga libri im që është në përgatitje e sipër, me titull "Të Drejtat e Njeriut sipas së Drejtës Islame dhe asaj Evropiane."

drejtat e sanksionuara nga Zoti, të parat, nuk e kanë fuqinë e duhur obliguese, ndërkaq të dytat, janë pjesë integrale të besimit islam.¹

Burimi kryesor i ligjit islam është: Kur'ani i shenjtë mbi bazën e të cilit është kultivuar Syneti, Ixhmai dhe Kijasi.

E drejta islame, në esencë, është me karakter fetar, ndërsa e drejta evropiane me karakter laik.

E drejta islame, në aspektin e materies, të cilën e rregullon, përfshin sferë më të gjerë, se sa që është rasti me të drejtën evropiane. Me të drejtën evropiane, nënkuptohet e drejta e Evropës kontinentale, e bazuar në traditat romake. E drejta romake, e cila qëndron në bazat e së drejtës së Evropës kontinentale, ka fituar artikulimin e saj më autoritativ, në kohën e Perandorit Justinian (527- 565), kur Perandoria Romake zyrtarisht ishte shtet i krishter. Legjislacioni i Justinianit, është themeluar në bazë të veprave të juristëve të epokës antoniane, kur paganizmi i vjetër e humbi ndikimin tek njerëzit e arsimuar, e krishterizmi ende nuk e kishte marrë vendin e tij. Kështu, që në esencë, e drejta romake paraqet të drejtën e përcjellur brez pas brezi nga njeriu njeriut. Kjo është e drejtë, e cila mund të ndryshohet, nëse këtë e kërkojnë rrethanat, në të njëjtën mënyrë sikur që edhe është formuluar.²

Libri i krishterë Bibla, nuk ka karakter ligjdhënës, prandaj në kulturat perëndimore, njerëzit janë ata, të cilët formulojnë ligje për njerëzit.

Të drejtat e njeriut, janë të patjetërsueshme dhe janë më të vjetra se të gjitha shtetet.

Ligjet e formuluar, nga njerëzit, mund të pësojnë ndryshime dhe janë të bazuara në teori. Sa herë që, një trup i ri ligjvënësish merr kompetenca autoriteti ose paraqitet një teori e re, e pëlqyer tek ata, atëhere dhe ligjet ndërrohen në përputhje me këtë. Legjislacioni hyjnor, në anën tjetër, është i pandryshueshëm dhe i gjithmonshëm, sepse Ai, që krijoi atë, është i Pavdekshëm dhe i Përjetshëm. Ai është Krijuesi, që krijoi njerëzit dhe caktoi për ata atë, që do t'u përgjigjej nevojave të tyre deri në fund të kohës.³

E drejta islame, në çdo vepër njerëzore, shikon kualitetin etik (husën dhe kubh). Ky kualitet etik, nuk mund të njihet përmes mendjes njerëzore, ai varet nga

¹ Mevdudi. Të Drejtat e Njeriut në Islam. Shkup. 1413. 1992. f.18

² Fikret Karçiç. Historia e së Drejtës së Sheriatit, f. 11. Prizren. 1994.

³ Mahmud Rida Murad. Islami me pak fjalë. f. 11. boton Gjurma. Prishtinë 2001.

Shpallja, sikurse predikojnë shkollat autoritative të mendimit islam. Në fushën e çështjeve indifferente juridike, i është lënë hapësirë normimit njerëzor.⁴

Bota përëndimore mburret me historinë e të drejtave të njeriut. Ajo zëshëm pohon, se koncepti i parë i të drejtave elementare të njeriut, rrjedh nga *Magna Carta* e Britanisë. Historiku i të drejtave të njeriut shkurtimisht, është si vijon:

Karta e Madhe e Lirive (*Magna Charta Libertatum*), viti 1215.

Ligji për të Drejtat (*Bill of Rights*), viti 1689;

Deklarata Amerikane e Pavarësisë, viti 1776. dhe

Deklarata Franceze për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarëve, viti 1789.⁵

Në Perëndim, *Magna Charta*, prej vitit 1215, kremtohet si dokument i madh, i cili, me shkrim, vërteton sigurinë juridike të të gjithë (atëbotë) "të lirëve" dhe, poashtu, e obligon edhe mbretin, që t'u përmbahet ligjeve valide.

Muslimanët e pranojnë Kur'anin si një bazë juridike, i cili i obligon të gjithë njerëzit, pa përjashtim, t'u përmbahen dispozitave të dhëna prej tij dhe atë, rreth 600 vjet para *Magna Chartas*. Muslimanët, jurisprudencën e tyre, e kanë fituar para 1400 vjetëve, prej Allahut, me shpalljen e Kur'anit, që vlen për të gjithë njerëzit, madje, për të gjithë krijesat që ekzistojnë dhe për të gjitha kohërat Ndërkaq, njerëzit në perëndim, këto të drejta, i kanë përmbledhur prej njerëzve të tjerë dhe për këtë gjë u deshën 1776 vjet.⁶

Formulimi i të drejtave të njeriut, në qarkun kulturor përëndimor, rrënjët e veta, i ka në një kryengritje, kundër dirigjimit të plotë 1700 vjeçar kishtar dhe kundër totalitarizmit sundues autokra. Kur'ani, për të gjithë muslimanët, është ligj i Zotit, prandaj, udhëheqësit u janë nënshtuar këtyre ligjeve, prej ditës së parë. Gjatë historisë, ka pasur regjime, sikurse ka edhe sot në botën islame, por autokracia e pushtetit, sipas Kur'anit, ka qenë dhe është shkelje e këtyre ligjeve! Prandaj, të shtypurit nuk është dashur, duke u thirrur në Zot, të shpikin fillimisht të drejtat e njeriut, e pastaj t'i fitojnë nga sunduesit.

Ata, vetëm, është dashur të kujdesen për kthimin në themelet Islame, që të largonin regjimin e padrejtë.

Është e rëndësishme të dihet se liritë e fituara në ndërkohë në perëndim, janë të instaluar në Kur'an shumë kohë përpara shek. 12-15. Krahas lirisë, në jetën islame, gjithsesi, hyjnë edhe një varg obligimesh ndaj Zotit dhe bashkësisë, të cilat

⁴ Fikret Karçiç. Historia e së Drejtës... f. 11-12.

⁵ Zejnullah Gruda. Mbrojta e të Drejtave Ndërkombëtare të njeriut. f. 8.

⁶ Christian H. Hoffmann. I shtrirë nga të gjitha anët. f. 41.

paraqesin bazë për një strukturë sociale, prej së cilës kultura perëndimore-hedoniste do të mund të mësonte.⁷

Mesazhi Islam, e ka konceptuar dhe sëndërtuar në praktikë qytetërimin, në të cilin nuk ka pasur kurrfarë vendi për nacionalizmin, kurrfarë interesash të veçanta, kurrfarë ndarje klasash, kurrfarë kishë, kurrfarë priftërie, kurrfarë aristokracie, në realitet, kurrfarë funksionesh trashëguese përgjithësisht. Qëllimi, ka qenë konstituimi i teokracisë, në raport me Zotin dhe demokracisë, ndërmjet njeriut dhe njeriut. Cilësia më e rëndësishme e këtij qytetërimi të ri – cilësi, që e dallon nga të gjitha lëvizjet e tjera në historinë njerëzore, - ka qenë fakti, se ai është koncipuar me anë të pranimit vullnetar të njerëzve të interesuar.⁸

Islami, beson në llojlloshmëri kulturash, civilizimesh, ngjyrash, gjuhësh, popujsh, vendesh dhe të gjitha këto, konsiderohen si shenja të fuqisë së Zotit, dhe ata mund të bashkëjetojnë paqësisht njëri përkrah tjetrit.

"O njerëz! Ne ju kemi krijuar juve prej një mashkulli dhe një femre dhe u kemi bërë popuj e fise që t'a njihni njëri-tjetrin. Më fisniku tek All-llahu është ai i cili më së shumti i ruhet Atij; All-llahu, me të vërtetë, është shumë i dishëm dhe i informuar mirë." (Kur'ani 49, 13).

Në mes shtatë civilizimeve të mëdha, të kohës sonë, vetëm Islami dhe Perëndimi kanë botëkuptim dhe qasje universale. Por, edhe përkundër kësaj, nëse ekziston vullnet i mirë nga të dy anët, universalizmi i tyre mund të koegzistojë paqësisht.

Tezat e P. Huntingtonit, në librin e tij "Përplasje e civilizimeve", kanë për qëllim gjatjen e armiqëve të rinj. Sipas tij, "shkakqet më të rëndësishme për konflikt, do të jenë të natyrës kulturore". që do të thotë se lufta e ardhshme botërore, nëse ndodh, do të jetë një luftë ndërmjet kulturave. Mendoj se ka rast, mundësi dhe hapsirë, që kulturat e ndryshme, e edhe ajo islame dhe krishtere, të gjejnë forma të të kuptuarit, sikurse e ka dëshmuar Islami gjatë historisë, dhe kështu apokalipsën e Huntingtonit ta zbulojnë ashtu siç është: Skenar i motivuar politikisht, i cili që më parë i arsyeton intervenimet e ardhshme!⁹

⁷ Ibid. f. 86-87.

⁸ Muhammed Asad. Rruga për Mekë. f. 406.

⁹ Ibid.f. 130.

Diskutueshmëria e Konventës

Punimet e Nyrnbergut dhe Kombet e Bashkuara kishin kuptim të veçantë, për gjithë ata që kishin qenë dëshmitarë të abuzimeve të tmerrshme të të drejtave të njeriut, në Evropën e okupuar nga nazistët.

Evropianët, me shekuj, kishin propozuar lidhje më të ngushta kulturore, ekonomike dhe politike midis tyre, por nuk ia arriten që të jetësonin për shkak rivaliteteve nacionaliste dhe kontesteve territoriale. Kështu, kemi ide dhe projekte nga filozofë evropianë për federata evropiane, apo konfederata të Evropës së krishterë. Në shek. XX, diplomatë evropianë, hedhin idenë për krijimin e një strukture të Evropës së integruar. Por, të gjitha këto ide mbetën në letër dhe të painstitucionalizuara, deri pas Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1946, në fjalimin e tij të njohur në Cyrih, Çerçili hedh idenë për formimin e Shteteve të Bashkuara të Evropës.¹⁰

Për evropianët që përpiqeshin për një bashkim politik, të drejtat e njeriut u bënë një prioritet me rëndësi. Në maj 1948, shumë nga organizatat, që promovonin integritet evropian, u takuan në Hagë, në Konferencën e Komitetit Nërkombëtar të Lëvizjeve për Bashkim Evropian. Aty, delegatët shpallën: "Ne dëshirojmë një Kartë të të Drejtave të Njeriut, që të garantojë lirinë e mendimit, tubimit dhe shprehjes, si dhe të drejtën për të formuar opozitë politike; ne dëshirojmë një gjykatë të drejtësisë, me sanksione adekuate për realizimin e kësaj Karte."¹¹

Konventa, për Mbrojtjen e të drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, është miratuar më 4 nëntor 1950. Ajo ka hyrë në fuqi më 3 shtator 1953, pasi që e kanë ratifikuar 10 shtete anëtare të Këshillit Evropian. Konventa Evropiane, ka rëndësi shumë të madhe, ngase është dokumenti i parë, që rregullat deklarative u ka dhënë karakter të detyrueshëm. Ka paraparë një mekanizëm, i cili ka për të siguruar zbatimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ndërmjet shumë subjekteve të një regjioni dhe, në fund, se hyrja në Këshillin e Evropës, kushtëzohet me respektimin e të drejtave të njeriut. Shkalla e demokracisë në ndonjë vend, matet qartë me qëndrimin e pushtetit ndaj të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.¹²

¹⁰ Mr. Blerim reka. E Drejta e Unionit Evropian. f. 27-28 boton KIEAI. Prishtinë. 2000.

¹¹ Mark W. Janis, Richard S. Kay dhe Anthony. W. Bradley. E drejta evropiane e të drejtave të njeriut. f. 31-32. Boton, Shtëpia Botuese, Libri Shkollor. Prishtinë. 2002.

¹² Zejnullah Gruda. Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut. Boton Universiteti i Prishtinës. Prishtinë 2001. f. 53..

Konventa Evropiane përmban 10 të drejta, që kanë qenë të parapara, në Deklaratën e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, të cilat i takojnë grupit të të drejtave dhe lirive civile e politike.

Gjatë diskutimit lidhur me Konventën, në Këshillin e Evropës më 1949-1950, delegatët shprehën mendimin se, do të ishte e këshillueshme të themelohej, jo vetëm një Gjykatë Evropiane, por gjithashtu edhe një Komision Evropian i të drejtave të njeriut.

Konventa në seksionin I përfshin të drejtat dhe liritë (deri tek neni 18). Në seksionin II (nga neni 19 deri në nenin 51), flet për Gjykatën Evropiane e të drejtave të Njeriut. Kurse në seksionin III (nga neni 52 deri në nenin 59), përfshin dispozita të ndryshme.¹³

Në Konventë, është paraparë krijimi i dy organeve, që duhet të sigurojnë respektimin e obligimeve nga Konventa. Këto janë: Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Duhet të theksojmë se, konventa është zgjeruar dhe plotësuar me një numër protokolesh. Ndryshimet më të mëdha, në gjithë mekanizmin e kontrollit të Konventës, ka sjellë Protokollin 11, në Vjenë, në tetor 1993. Ai ka hyrë në fuqi, më 1 nëntor 1998. Me këtë, bëhet anulimi i Komisionit dhe Gjykatës për të Drejtat e Njeriut dhe krijohet një Gjykatë e vetme permanente Evropiane për të drejtat e njeriut. Ajo që është me rëndësi të përmendim, me këtë rast, dhe që bie ndesh me dënimin islam, është Protokollin Nr. 6 ndër më të fundit që i është shtuar Konventës, është nënshkruar më 28 prill 1983 dhe ka hyrë në fuqi prej 1 marsit 1985. Ai ka sjellë një risi në legjislationin penal: *duke anuluar dënimin me vdekje, ndonëse kjo ishte objekt i një diskutimi të gjatë.*¹⁴

Konventa Evropiane, është: *“bërë në Romë, më 4 nëntor 1950, në anglisht dhe frëngjisht, të dy tekstet janë njësoj autentik. Një kopje e vetme, mbetet e depozituar në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm, ua përcjell kopjet e vërtetuaru secilit nga nënshkruesit.”*¹⁵

Unë, në vazhdim, vemendjen time do të përqendroj tek seksioni I i Konventës.

Kurse, Deklarata Islame universale e të Drejtave të Njeriut, është:

¹³ Shih Mark W. Janis, Richard S. Kay, Anthony E. Bradley, E drejta evropiane... f. 585-598.

¹⁴ Arben Puto, E Drejta ndërkombëtare Publike. Tiranë, 2002, f. 228

¹⁵ Ibid, f. 598. Tekstin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e kam nxjerrë nga po ky libër të përkthyer nga Zejnullah Gruda dhe Armend Gruda, nga faqja 586 deri në faqen 590.

“Është dokumenti i dytë bazë, i shpallur prej Këshillit Islam, në fillim të shekullit 15 të epokës Islame (shek.20). E para ishte Deklarata Islame Universale, e shpallur prej Konferencës Internacionale, mbajtur në Londër, prej 12- 15 prill 1980.”¹⁶

Deklarata Islame Universale e të Drejtave të Njeriut, bazohet në Kur'an dhe Synet dhe është përpiluar prej studjuesve eminent musliman, juristëve dhe përfaqësuesve të lëvizjeve dhe të mendimit Islam.

Dashtë All-llahu t'i shpërblej ata të gjithë për përpjekjet e tyre dhe të na udhëheq në rrugën e drejtë.

Paris 21 Ka'ade 1401 Salim Azam

19 shtator 1981 Sekretari i Përgjithshëm ”

Dokumenti i përgjithshëm i të drejtave të njeriut në Islam

*(19 shtator 1981.)*¹⁷

Me emrin e Allahut, Bamirësit të Përgjithshëm, Mëshiruesit.

Preambula

Këto janë të drejta, të cilat i ka vendosur Krijuesi - i lartësuar qoftë Ai. Njeriu, kushdo qoftë ai, nuk ka të drejtë që t'i ndryshojë ose t'i çenonjë ato. Pacënueshmëria e tyre, nuk mund të bijë nën ndikimin as nga vullneti i individit dhe as nga vullneti i shoqërisë, të përfaqësuar përmes institucioneve të çfarëdo lloj natyre, ose çfarëdo lloj force. Konfirmimi i këtyre të drejtave, paraqet rrugën drejt ngritjes së shoqërisë së mirëfilltë islame, drejt:

1. Shoqërisë, në të cilën, janë të barabartë të gjithë dhe ku nuk ka privilegje ose diskriminim të individit, për shkak të origjinës, racës, gjinisë, ngjyrës, gjuhës ose religjionit.

2. Shoqërisë, në të cilën, barazia është bazë e posedimit të të drejtave dhe përmbushjes së obligimeve, barazisë, e cila bazën e saj, e ka në origjinën e përbashkët të gjithë njerëzimit: “O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre..” (Kur'ani 49, 13.); dhe tek nderimi me çka e ka pajisur Krijuesi, i lartësuar qoftë Ai: “Ne, vërtet, nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit), u mundësuam të udhëtojnë hipur në tokë e në det. I begatuam me ushqime të mira, i

¹⁶ Shih [http:// www.alhewar.com/ISLAMDECL.html](http://www.alhewar.com/ISLAMDECL.html)

¹⁷ Shih [http:// www.alhewar.com/ISLAMDECL.html](http://www.alhewar.com/ISLAMDECL.html) Përkthimin e Deklaratës Islame për të Drejtat e Njeriut e kam bërë nga gjuha angleze, të marrë nga kjo adresë në internet.

vlerësuar ata (i lartësuar) ndaj shumicës së krijesave që Ne i krijuam." (Kur'ani 17, 70).

3. Shoqërisë, në të cilën, liria e njeriut, me të cilën ai është i lindur është në pajtim me kuptimin e jetës së tij, dhe në mbrojtjen e së cilës, ai, e sheh vetën e tij, të mbrojtur nga persekutimi, dhuna, nënçmimi dhe robërimi.

4. Shoqërisë, e cila, bërthamën e saj e sheh në familje, së cilës, për këtë arsye, i ofron mbrojtjen, respektin dhe i siguron asaj të gjitha parakushtet për stabilitet dhe prosperitet.

5. Shoqërisë, në të cilën, zotëriu dhe shërbëtori, para ligjit të Krijuesit, janë të njëjtë, pa e privilegjuar ose diskriminuar njërin ose tjetrin.

6. Shoqërisë, në të cilën, fuqia i është besuar një sundimtari të mirë që, ai t'i sendërtojë qëllimet në atë mënyrë sikurse ka urdhëruar Sheriati (ligji i Krijuesit).

7. Shoqërisë, në të cilën, secili është i bindur se, vetëm Zoti është sundimtar i gjithë universit, dhe se çdo gjë është e varur nga krijimi i Zotit, si dhuratë e mirësisë së tij, kurse para kësaj askush nuk kishte asgjë në dispozicion. Është e drejtë e çdo njeriu, që të marrë pjesën e njëjtë, të kësaj të dhëne nga Zoti: "*Dhe për ju nënshtroni gjithë ç'ka në qiej dhe gjithë ç'ka në tokë.*" (Kur'ani 45, 13).

8. Shoqërisë, në të cilën vendimet politike merren përmes konsultimit (*esh shūra*) dhe të cilat, nëpërmjet Ummetit, mbikqyren dhe zbatohen. "*...dhe ata që konsultohen mes vete*" (Kur'ani 42, 38).

9. Shoqërisë, në të cilën, gjithsecilit i është dhënë mundësia e njëjtë, që secili sipas prirjeve dhe talentit të marr përgjegjësi. Ai për veprat e tij është përgjegjës para Ummetit, kurse në botën tjetër, para Krijuesit të tij: "*Secili nga ju është bari dhe është përgjegjës për tufën e tij*" (hadhithi sipas Buhariut, Muslimit, Ebu Davudit, Tirmidhiut dhe Nesaiut).

10. Shoqërisë, në të cilën sundimtari dhe i shtetasi i tij, janë të barabartë para vendimeve dhe masave gjyqësore.

11. Shoqërisë, në të cilën, secili është ndërgjegje e gjithë shoqërisë. Është e drejtë e tij, që të ngrejë padi kundër çdo njeriu, i cili bën gabime në drejtim të drejtave të shoqërisë. Ai ka të drejtë, që të kërkojë edhe përkrahjen nga të tjerët, të cilët janë të detyruar, që të jenë në anën e tij dhe që në çështjen e tij të drejtë, të mos e lënë pa përkrahje.

12. Shoqërisë, e cila, refuzon çfarëdo forme të tiranisë dhe, e cila, garanton lirinë, sigurinë, dinjitetin dhe drejtësinë, ndërsa zbaton të drejtat që paraqet Ligji

(Sheriati) i Zotit për njeriun, vepron pozitivisht në sendërtimin e tyre dhe mbikqyr ruajtjen e tyre.

Këto të drejta i shpallën-kumtohen botës "me këtë dokument"¹⁸:

Krahasim i Deklaratës Islame dhe Konventës Evropiane

Deklarata Islame	Konventa Evropiane
Neni 1- E drejta për jetë a). Jeta e njeriut është e shenjtë dhe e pacënueshme dhe duhet bërë çdo përpjeke për ta mbrojtuar atë. Në veçanti, askush nuk duhet të jetë i ekspozuar ndaj dëmtimit apo vdekjes, përveçse nën autoritetin e Ligjit: " <i>Kush e mbyt një njeri (pa të drejtë), pa pasë mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pasë bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si t'i kishte mbytur gjithë njerëzit. E kush e ngjall (bëhet shkak që të jetë ai gjallë) është si t'i kishte ngjallur (shpëtuar) të gjithë njerëzit "</i> (Kur'ani 5, 32). b). Sikurse gjatë jetës, gjithashtu edhe pas vdekjes, shenjtëria e trupit të njeriut është e pacënueshme. Është obligim i besimtarit, që kur ta mbështjellë trupin e personit të vdekur me çarçaf të vdekjes, ai le ta bëjë një gjë të tillë me ndërgjegje. (hadithi, transmeton Muslimi, Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Nesaiu): "Mos e shani të vdekurin, sepse së shpejti, do t'iu gjejë ajo që ia përgatitni vetes. (hadithi, sipas Buhariut).	Neni 1- Obligimi për të respektuar të drejtat e njeriut Palët e larta kontraktuese do t'i sigurojnë çdokujt brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe liritë e përkufizuara në seksionin I të kësaj Konventeje.

¹⁸ Me këtë dokument nënkuptohet Deklarata Islame për të Drejtat e Njeriut.

* Me fjalën Ligj në Deklaratën Islame nënkuptojmë gjithnjë Ligjin Islamik (A. S.)

Neni 2- E drejta për liri a) Njeriu lind i lirë. Asnjë sulm nuk duhet bërë mbi të drejtën e tij për liri, përveçse nën autoritetin dhe procesin e duhur të ligjit: "<i>Secili lind me natyrë të tij të pastër.</i>" (hadithi sipas Buhariut dhe Muslimit); "<i>Qysh kur po robëroni njerëzit, kur nënat e tyre i kanë lindur të lirë?!</i>" (thënie e h.Umerit). b) Çdo individ dhe çdo popull ka të drejtën e pacënueshme për liri, në të gjitha format e saj- fizike, kulturore, ekonomike dhe politike- dhe duhet t'i jepet e drejta për të luftuar me të gjitha mënyrat e lejueshme kundrejt çdo shkeljeje apo privimi të kësaj të drejte; dhe çdo individ apo komb i shtypur ka njohjen e së drejtës legjitime të përkrahjes së individëve apo popujve të tjerë në një përpjekje të tillë: "<i>Nuk do të përgjigjet ai, i cili e kthen me të njëjtën masë dëmin e pësuar.</i>" (Kur'ani 42, 41); "<i>Ata të cilët kur Ne u mundësojmë vendosjen në tokë, e falin namazin, japin zeqatin, urdhërojnë për të mirë dhe largojnë prej të keqes</i>" (Kur'ani 22, 41).	Seksioni I- Të drejtat dhe liritë Neni 2- E drejta për jetë 1. E drejta e çdokujt për jetë, do të mbrohet me ligj. Askush nuk do të privohet nga jeta e tij me qëllim, pos në ekzekutimin e ndonjë vendimi të ndonjë gjykate, pas gjetjes fajtor për ndonjë krim, për të cilin ky dënim është paraparë me ligj. 2. Privimi nga jeta nuk do të konsiderohet i shkaktuar në kundërshtim me këtë nen, kur rezulton nga përdorimi i forcës që është absolutisht e nevojshme: a. në mbrojtje të cilido person nga dhuna joligjore; b. me qëllim që të kryhet ndonjë arrestim ligjor ose për të parapenguar ikjen e ndonjë personi të paraburgosur ligjshëm; c. në veprim të ndërmarrë ligjshëm me qëllim të shtypjes së ndonjë trazire a kryengritjeje.
--	---

Neni 3 - E drejta për barazi dhe ndalimi i diskriminimit.

a) Të gjithë personat janë të barabartë përpara Ligjit dhe u jepet e drejta për mundësi dhe mbrojtje të barabartë nga Ligji: "*Arabët nuk kanë përparësi ndaj joarabëve, dhe as joarabët nuk kanë përparësi ndaj arabëve, as të bardhët ndaj të zinjëve dhe as të zinjët ndaj të bardhëve, veçse me devotshmëri (hadith i Pejgamberit a.s.); " Edhe sikur të vidhte Fatimja, vajza e Muhammedit, edhe asaj do t'i pritej dora " (hadithi sipas Buhariut, Muslimit, Ebu Davudit, Tirmidhiut dhe Nesaiut); "Më i dobti nga ju, është më i forti tek unë, derisa t'ia kthej të drejtën (që i takon), kurse më i forti nga ju, është më i dobti tek unë, derisa ia marr të drejtën e tjetrit. (thënia e Halifit Ebu Bekër me rastin e marrjes së pushtetit).*

b) Të gjithë personave, duhet t'u jepet e drejta për shpërblim të barabartë për punë të barabartë: "*Ju të gjithë jeni bijtë e Ademit, kurse Ademi është krijuar prej balte " (thënia e Pejgamberit a.s. me rastin e haxhit lamtumirës, hadithi transmetohet nga Ahmedit); " E, secilit sipas veprave që bën, i takon shkalla " (Kur'ani 46, 19); " Gjaku i të gjithë muslimanëve është i barabartë me të tjerët. ").*

Asnjë personi nuk duhet t'i mohohet mundësia për të punuar, apo të diskriminohet në çfarëdo forme, apo të ekspozohet kundrejt një rreziku më të madh fizik për shkak të besimit fetar, ngjyrës, racës, origjinës, gjinisë apo gjuhës: "*Andaj, ecni nëpër pjesë të saj (tokës) dhe shfrytëzoni begatitë e Tij " (Kur'ani 67, 15); " E kush punoi ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. " (Kur'ani 99, 7-8).*

Neni 3- Ndalimi i torturës

Askush nuk do t'i nënshtrohet torturës ose trajtimit apo ndëshkimit jonjerëzor apo degradues.

Neni 4-E drejta për drejtësi

a) Çdo person ka të drejtë të trajtohet në përputhje me Ligjin, dhe vetëm në përputhje me ligjin: "Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrojeni atë të Allahu (te libri i Tij) dhe te i Dërguari " Kur'ani 4, 59); " Që edhe ti të gjykosësh me atë që të zbreti Allahu, e mos ndiq dëshirat e tyre " (Kur'ani 5, 49).

b) Çdo person ka jo vetëm të drejtë, por gjithashtu e ka obligim të protestojë kundrejt padrejtësisë: t'i drejtohet për ndihmë mjeteve të parashikuara me Ligj, për sa i përket ndonjë dëmtimi apo humbjeje personale të padrejtë; të vetmbrojtjes kundrejt çdo akuze që është ngritur kundër tij dhe për të siguruar vendim gjyqësor të drejtë përpara një trupi të pavarur gjyqësor, në ndonjë konflikt me autoritetet publike apo me ndonjë person tjetër: "Allahu nuk do publikimin e shprehjeve të këqia, përveç (publikimit) nga ai, të cilit i është bërë padrejtësi. " (Kur'ani 4, 148); " Njeriu i ndihmon atij që bën padrejtësi, ose atij që i bëhet padrejtësi. Unë ju ndaloj, të bëni padrejtësi, nëse bëni vepër të mirë unë ju lavdëroj " (sipas Buhariut, Muslimit dhe Tirmidhiut); " Imami (prijësi) është mbrojtje, për të luftohet dhe ai është strehë ". (sipas Buhariut dhe Muslimit).

c) Është e drejtë dhe detyrë e çdo personi të mbrojtë të drejtat e ndonjë personi tjetër dhe të bashkësisë në përgjithësi (hisba): "A dëshironi t'ju them se kush është dëshmitari më i mirë? Është ai i cili vjen me dëshminë e tij, para se të pytet për të." (hadithi sipas Muslimit, Ebu Davudit, Tirmidhiut dhe Nesaiut).

d) Asnjë person nuk duhet të diskriminohet, ndërsa përpiqet të mbrojtë të drejtat private dhe publike: "Ai që pohon, është i obliguar të japë dëshmi " (hadithi, sipas Buhariut, Muslimit, Ebu Davudit, Tirmidhiut, Nesaiut); " Kur, para teje, paraqiten dy

Neni 4- Ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar

1. Askush nuk do të mbahet në skllavëri ose robëri.

2. Askujt nuk do t'i kërkohet të kryejë punë të dhunshme ose të detyruar.

3. Për qëllimet e këtij neni, termi " punë e dhunshme ose e detyruar " nuk do të përfshijë:

a. cilëndo punë të kërkuar për të bërë gjatë paraburgimit të zakonshëm të imponuar në pajtim me dispozitat e nenit 5 të kësaj Konventeje ose gjatë lëshimit të kushtëzuar nga ndonjë paraburgim i tillë;

b. cilindo shërbim të karakterit ushtarak ose, në rast të kundërshtuesve të vetëdëshëm në vendet ku ata njihen, shërbimi i kërkuar në vend të shërbimit të detyruar ushtarak;

c. cilindo shërbim të kërkuar në rast të ndonjë emergjence ose katastrofe që rrezikon jetën ose mirëqenien e komunitetit;

ç. Cilëndo punë ose shërbim që është pjesë e detyrimeve normale civile.

palë, vendos vetëm pasi t'i kesh dëgjuar të dyja palët, sepse kjo procedurë është konform marrjes së vendimit dhe e bën vendimin të saktë. " (hadithi sipas Ebu Davudit dhe Tirmidhiut). e) Është e drejtë dhe detyrë e çdo Muslimani të refuzojë t'i bindet çfarëdo urdhëri, i cili është në kundërshtim me Ligjin, pa marrë parasysh se prej kujt është lëshuar ai: "Nuk ka bindje ndaj krijesës që çon në mëkatim ndaj Krijuesit. " (hadithi sipas Buhariut, Muslimit, Ebu Davudit, Tirmidhiut dhe Nesaiut); " Muslimani është vëlla për muslimanin, ai nuk i bën padrejtësi dhe respekton tjetrin ". (hadithi sipas Buhariut).	
Neni 5- E drejta për procedurë të drejtë gjyqësore a) Asnjë person nuk duhet të konsiderohet fajtor i një kundërvajtjeje dhe të bëhet përgjegjës dhe t'i nënshtrohet ndëshkimit, veçse pasi t'i provohet fajësia, para një trupi gjyqësor të pavarur: "Çdo njeri në bashkësinë time konsiderohet i pafajshëm, përveç atyre që e pranojnë të kundërtën publikisht. " (sipas Buhariut dhe Muslimit). b) Asnjë person nuk duhet të shpallet fajtor, përveçse pas një procesi gjyqësor të ndershëm dhe pas mundësisë për mbrojtje që i është siguruar atij: "Ne nuk dënuam askë para se t'ia dërgojmë të dërguarin " (Kur'ani 17, 15); " Nuk është ndonjë mëkat nëse keni gabuar padashje, por (është mëkat) ajo që zemrat tuaja e bëjnë qëllimisht " (Kur'ani 33, 5). c) Ndëshkimi duhet të jepet në përputhje me ligjin, në përpjestim me seriozitetin e shkeljes dhe me marrjen në konsideratë të rrethanave, nën të cilat është kryer ajo: "Nëse ndonjë njeri i pandershëm u sjell ndonjë lajm, sqaroheni mirë " (Kur'ani 49, 6). d) Asnjë veprim nuk duhet të konsiderohet krim, derisa ai nuk parashikohet si i tillë në	Neni 5- E drejta në liri dhe siguri 1. Çdokush ka të drejtë në liri dhe siguri të personit. Askush nuk do të privohet nga liria e tij, pos në rastet vijuese dhe në pajtim me procedurat e parashikuara me ligj: a. paraburgimi i ligjshëm ose paraburgimi i ndonjë personi pas gjetjes fajtor nga ndonjë gjykatë kompetente; b. arrestimi i ligjshëm ose paraburgimi i ndonjë personi për mosbindje ndaj urdhërit ligjor të ndonjë gjykate ose me qëllim të sigurohet përmbushja e cilitdo obligim të parashikuar me ligj; c. arrestimi ose paraburgimi i ndonjë personi i kryer me qëllim të sjelljes së tij para autoritetit kompetent legal mbi dyshimin e arsyeshëm të kryerjes së ndonjë kundërvajtjeje ose kur konsiderohet me arsye e nevojshme të parapengohet kryerja e ndonjë kundërvajtjeje ose ikja pasi të ketë bërë ashtu; ç. paraburgimi i ndonjë të mituri me urdhër të ligjshëm me qëllim të mbikqyrjes edukative ose paraburgimi i tij i ligjshëm me qëllim të sjelljes së tij

formulimin e qartë të Ligjit: "*Ato janë norma të All-llahut* " (Kur'ani 2, 229).

e) Çdo person është përgjegjës për veprimet e tij. Përgjegjësia për një krim nuk mund të shtrihet tek anëtarët e tjerë të familjes apo të rrethit të tij, të cilët përndryshe nuk janë përfshirë direkt apo indirekt në kryerjen e krimit në fjalë: "Dhe asnjë mëkatar nuk do të bartë mëkatet e tjetrit. " (Kur'ani 17, 15); " *Çdo kush është përgjegjës për atë që e bënë vet.* " (Kur'ani 52, 21); " *Zoti na ruajtë- tha ai- si të marrim tjetër në vend të atij ku e gjetëm gotën tonë?! Atëhere ne jemi mizorë!* " (Kur'ani 12, 79).

para autoritetit kompetent legal;

d. paraburgimi i ligjshëm i personave për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive, i personave të mendjes jo të shëndoshë, alkoolistëve, ose i të varurve nga drogat ose vagabondëve;

dh. Arrestimi ose paraburgimi i ligjshëm i ndonjë personi për të parandaluar hyrjen e paautorizuar në vend ose i ndonjë personi kundër të cilit merret aksion me synim të deportimit ose ekstradimit.

2. Çdo kush që është arrestuar do të informohet me shpejtësi, në një gjuhë që e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe për çfarëdo padie kundër tij.

3. Çdokush që është arrestuar ose paraburgosur në pajtim me dispozitat e paragrafit 1.c të këtij neni do të sillet me shpejtësi para ndonjë gjyqtari ose zyrtari tjetër të autorizuar sipas ligjit për të ushtruar pushtet gjyqësor dhe do të ketë të drejtë në proces brenda një kohe të arsyeshme ose në lirim në pritje të procesit. Lirimi mund të kushtëzohet me garanci për t'u paraqitur për proces.

4. Çdokush që është privuar nga liria e tij me arrestim ose paraburgim, do të ketë të drejtë të ndërmarrë procedura sipas të cilave do të vendoset me shpejtësi ligjshmëria e paraburgimit të tij nga ndonjë gjykatë dhe do të urdhërohet lirimi i tij nëse paraburgimi i tij nuk është i ligjshëm.

Çdokush që ka qenë viktimë e arrestit ose paraburgimit në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, do të ketë të drejtë të zbatueshme në kompensim.

Neni 6 - E drejta për t'u mbrojtjur kundrejt shpërdorimit të pushtetit

a) Çdo person ka të drejtë të mbrohet kundrejt shqetësimeve prej organeve zyrtare. Ai nuk është përgjegjës për të dhënë llogari për vetveten, përveçse të bëjë mbrotjen kundër akuzave të ngritura kundër tij, apo ai të jetë gjetur në një situatë, ku mund të jetë ngritur një padi në mënyrë të arsyeshme, në lidhje me dyshimin e përfshirjes së tij në një krim: *"E ata që fyejnë besimtarët dhe besimtarët, për çka ata nuk janë fajtorë, ata kanë ngarkuar veten me një mëkat shumë të madh."* (Kur'ani 33, 58).

Neni 6 - E drejta në gjykim të drejtë

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve civile të tij ose të çfarëdo padie penale kundër tij, çdokush ka të drejtë në degjësë fer dhe publike brenda një kohe të arsyeshme nga ana e ndonjë tribunali të pavarur dhe të paanshëm, të themelaur sipas ligjit. Aktgjykimi do të shpallet publikisht, por shtypi dhe publiku mund të përjashtohen nga tërë procesi ose një pjesë e tij, në interes të moralit, rendit publik ose sigurisë kombëtare në ndonjë shoqëri demokratike, kur interesat e të rinjve ose mbrojtja e jetës private të palëve kërkojnë kështu, ose deri në shkallën rreptësisht të nevojshme në opinionin e gjykatës në rrethanat speciale ku publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdokush i paditur me ndonjë kundërvajtje penale, do të supozohet i pafajshëm, derisa të mos provohet fajtor në pajtim me ligjin.

3. Çdokush i paditur me ndonjë kundërvajtje penale ka të drejtat vijuese minimale:

a. të informohet me shpejtësi, në një gjuhë që e kupton, dhe në hollësi për natyrën dhe shkakun e akuzave kundër tij;

b. të ketë kohë dhe lehtësi adekuate për përgatitjen e mbrojtjes së tij;

c. të mbrojë veten në person ose përmes ndihmës legale të zgjedhjes së tij, ose nëse nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar për ndihmën legale, t'i jepet pa pagesë kur interesat e drejtësisë e kërkojnë këtë;

ç. të hetojë ose të bëjë të hetohen dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë pjesëmarrjen dhe hetimin e

	dëshmitarëve për të, nën kushte të njëjta si të dëshmitarëve kundër tij; d. të ketë ndihmën falas të ndonjë përkthyesi nëse nuk mund të kuptojë ose flasë gjuhën e përdorur në gjykatë.
Neni 7-E drejta për - t'u mbrojtur kundrejt torturës Asnjë person nuk duhet t'i nënshtrohet torturës mendore apo trupore, apo të poshtërohet, apo të kërcënohet me dëmtim, ai vet, ndonjë i afërt apo që është i dashur për të, apo të detyrohet forcërisht për të pohuar para komisionit të një krimi, apo të jetë i detyruar të miratojë një akt, i cili është i dëmshëm për interesat e tij: "<i>Ata që i torturojnë njerëzit në këtë botë, do të dënohen nga Zoti në botën tjetër.</i>" (hadithi sipas Buhariut, Muslimit, Ebu Davudit, Tirmidhiut dhe Nesaiut): "<i>Zoti ia ka falë bashkësisë sime gabimin, harresën dhe atë në çka është e detyruar.</i>" (hadithi sipas Ibn Maxhes).	Neni 7- S'ka ndëshkim pa ligj 1. Askush nuk do të mbahet fajtor për çfarëdo shkeljeje penale për shkak të çfarëdo akti ose lëshimi, që nuk ka përbërë ndonjë shkelje penale sipas së drejtës kombëtare ose ndërkombëtare në kohën kur është kryer. E as nuk do të imponohet ndonjë dënim më i rëndë se që ishte i zbatueshëm në kohën kur është kryer shkelja penale. 2. Ky nen nuk do të cenojë procesin dhe ndëshkimin e çfarëdo personi, për çfarëdo akti ose lëshimi që, në kohën kur ishte kryer, ishte penal sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës të njohura nga kombet e civilizuar.
Neni 8-E drejta për mbrojtjen e nderit dhe reputacionit Çdo person ka të drejtë të mbrojë nderin dhe reputacionin e tij kundrejt shpifjeve, akuzave të pabaza, apo përpjekjeve të paramenduara të përgojosjeve dhe shantazheve: "<i>Gjaku juaj, pasuria juaj dhe nderi juaj janë të shenjtë, sikurse është e shenjtë kjo ditë e juaj, në këtë muaj tuajin dhe në këtë qytetin tuaj</i>" (nga Haxhi i Lamtumirës të Pejgamberit a.s. në Mekë); "<i>Dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit, dhe mos përgojoni njëri tjetrin.</i>" (Kur'ani 49, 12); "<i>Dhe mos etiketoni njëri-tjetrin me llagape</i>" (Kur'ani 49, 11).	Neni 8- E drejta në respekt për jetën private dhe familjare 1. Çdokush ka të drejtë në respekt të jetës private dhe familjare të tij, të shtëpisë së tij dhe të korrespondencës së tij. 2. Nuk do të ketë përzjerje nga ndonjë autoritet publik në ushtrimin e kësaj të drejte, pos si në pajtim me të drejtën dhe si është e nevojshme në ndonjë shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike ose mirëqenies ekonomike të vendit, për parapengimin e çregullimit dhe krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Neni 9-E drejta për strehim

a) Çdo person i persekutuar ose i shtypur, ka të drejtë të kërkojë strehim dhe azil. Kjo e drejtë i garantohet çdo qenie njerëzore, pavarësisht prej racës, religjionit, ngjyrës apo gjinisë: *"E nëse ndokush prej idhujtarëve të kërkon strehim, ti strehoje në mënyrë që t'i dëgjojë fjalët e Allahut (Kur'anin), e mandej përcille deri në vendin e tij të sigurt."* (Kur'ani 9, 6).

b) Shtëpia e Zotit, Qabja në Mekë, është vend i shenjtë për të gjithë muslimanët: *"Dhe kush hyj në te, ai është i sigurt."* (Kur'ani 3, 97).

"Dhe kur shtëpinë (Qaben) e bëmë vendkthimi dhe vendsigurie për njerëzit" (Kur'ani 2, 125), *"Të cilën Ne e bëmë të barabartë për njerëz, qofshin vendas ose të ardhur"* (Kur'ani 22, 25).

Neni 9- Liria e mendimit, ndërgjegjës dhe fesë

1. Çdokush ka të drejtë në liri të mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë: kjo e drejtë përfshin lirinë për të ndërruar fenë ose besimin dhe lirinë e tij të manifestojë, vetëm ose në bashkësi me të tjerët dhe në publik ose në privacy, fenë ose besimin e tij, në adhurim, predikim, praktikim dhe rite.

2. Liria për të manifestuar fenë ose besimin do t'i nënshtrohet vetëm kufizimeve të tilla, çfarë janë parashkruar me ligj dhe që janë të nevojshme në ndonjë shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për ruajtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Neni 10-Të drejtat e pakicave a) Parimi kur'anor nuk ka detyrim në fe rregullon të drejtat fetare të pakicave jomuslimane: "<i>Në fe nuk ka dhunë.</i>" (Kur'ani 2, 256). b) Në një vend Musliman pakicat fetare duhet të kenë alternativë për të qenë të qeverisur, për sa i përket çështjeve të tyre civile dhe personale, sipas Ligjit Islamik apo prej ligjeve të vet atyre: "<i>Po nëse të vijnë, ti ose gjykoji ose ktheju shpinën! Dhe nëse ua kthen shpinën, ata nuk mund të bëjnë asgjë. Por nëse i gjykon, gjykoji drejt sepse All-llahu i do të drejtët.</i>" (Kur'ani 5, 42); "<i>E përse ata kërkojnë prej teje që t'i gjykosh Ti kur e kanë Tevratin, ku gjenden normat e All-llahut? Pastaj ata prapë i kthejnë shpinën.</i>" (Kur'ani 5, 43); "<i>Edhe pasuesit e Inxhilit le të gjykojnë sipas asaj që ka shpallur Allahu në ta.</i>" (Kur'ani 5, 47).	Neni 10- Liria e shprehjes 1. Çdokush ka të drejtë në liri të shprehjes. E drejta do të përfshijë lirinë për të pasur opinione dhe për të marrë dhe dhënë informacione dhe ide pa interferencë nga autoritetet publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk do t'i parapengojë shtetet nga kërkimi i licencimit të ndërmarrjeve transmetuese, të televizionit dhe të kinemasë. 2. Ushtrimi i këtyre lirive, pasi bart në vete detyra dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet formaliteteve, kushteve, restriksioneve ose dënimeve të tilla siç janë parashkruar me ligj dhe janë të nevojshme në ndonjë shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për parapengimin e çrregullimit ose krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, për mbrojtjen e reputacionit ose të të drejtave të të tjerëve, për parapengimin e zbulimit të informacioneve të marra në besim, ose për ruajtjen e autoritetit dhe paanësisë së gjyqësisë.
Neni 11-E drejta dhe detyrimi për të marrë pjesë në mënyrën e qeverisjes dhe administrimin e çështjeve publike I nënshtuar ndaj Ligjit, çdo individ në bashkësi (Ummet) i jepet e drejta për të marrë detyra publike: "<i>Dhe ata që konsultohen mes vete</i>" (Kur'ani 42, 38); "<i>Gjaku i çdo muslimani është i barabartë; ata e ndihmojnë njëri tjetrin; madje edhe më i thjeshti prej tyre përpiqet të fitoj sigurinë e përhashkët.</i>" (sipas Ahmetit). Procesi i konsultimit të lirë (Shura) është baza e marrëdhënieve administrative midis qeverisë dhe popullit. Populli gjithashtu ka të drejtë të zgjedhë dhe të heqë sundimtarët e vet në përputhje me këtë parim: "<i>Unë jam udhëheqësi juaj, por në të njëjtën kohë nuk</i>	Neni 11- Liria e tubimit dhe e bashkimit 1. Çdokush ka të drejtë në liri të tubimit paqësor me të tjerët, përfshirë të drejtën për të formuar dhe për t'iu bashkuar sindikatave për mbrojtjen e interesave të tyre. 2. Kurrfarë kufizimesh nuk do të vendosen në ushtrimin e këtyre të drejtave, pos atyre çfarë janë parashkruar me ligj dhe janë të nevojshme në ndonjë shoqëri demokratike në interesin e sigurisë kombëtare, ose sigurisë publike, për parapengimin e çrregullimit dhe krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të

jam më i miri i juaj. Nëse shihni se punoj drejt, më përkrahni, e nëse vëreni se bëj gabime, më thoni. Më dëgjoni, nëse unë jam i dëgjueshëm ndaj Zotit, dhe Pejgamberit të Tij, e nëse unë nuk jam i dëgjueshëm, atëherë as ju nuk jeni të obliguar që të më dëgjoni mua. " (thënia e Halifit Ebu Bekr).	tjerëve. Ky nen nuk do të parapengojë imponimin e restriksioneve të ligjshme në ushtrimin e këtyre të drejtave nga pjestarët e forcave të armatosura, të policisë ose të administratës së shtetit.
Neni 12 - E drejta për lirinë e besimit, mendimit dhe të folurit a) Çdo person ka të drejtë të shprehë mendimet dhe bindjet e tij, derisa ai qëndron brenda kufijve të parashikuar prej Ligjit. Megjithatë, askujt nuk i jepet e drejta për të përhapur gënjeshtër, apo për të qarkulluar thashetheme, të cilat mund të nëpërkëmbin dinjitetin publik, apo të kënaqet me përgojime, aluzione apo të lëshojë shpifje përgojuese ndaj personave të tjerë: "Po nëse hipokritët dhe ata që kanë zemra të sëmurura, dhe ata që përhapin gënjeshtër në Medinë, nuk ndalen. Ne do të bëjmë që ti të dominosh mbi ta e pastaj ata nuk do të jenë fqinj me ty në të, vetëm një kohë të shkurtër. (Do të jenë) Të mallkuar, kudo që të ndeshen do të kapen dhe do të mbyten " (Kur'ani 33, 60-61). b) Ndjekja e ditorisë dhe kërkimi i së vërtetës, është jo vetëm e drejtë, por edhe detyrë e çdo muslimani: "Unë ju këshilloj vetëm me një gjë: për hir të Allahut të angazhoheni sinqerisht dy nga dy ose një nga një, e pastaj të mendoni thellë" (Kur'ani 34, 46). c) Është e drejtë dhe detyrë e çdo Muslimani të kundërshtojë dhe të luftojë (brenda kufijve të lejuar prej Ligjit) kundër shtypjes, madje edhe nëse kjo përfshin mospranimin e autoritetit më të lartë të shtetit: "I Dërguari i Allahut është pyetur: cila luftë e shenjtë është më e mira? Ai ka thënë: Fjala e së vërtetës drejtuar sundimtarit despot " (sipas Tirmidhiut dhe Nesaiut).	Neni 12- E drejta në martesë Burrat dhe gratë e moshës martesore kanë të drejtë të martohen dhe të themelojnë familje, në pajtim me ligjet kombëtare që qeverisin ushtrimin e kësaj të drejteje.

d) Nuk duhet të ketë pengesa në propagandimin e informacionit, me kusht që kjo të mos rrezikojë sigurinë e shoqërisë apo shtetit, dhe të kufizohet brenda kufijve të caktuar nga Ligji: <i>"Kur atyre u vjen diçka që ka të bëjë me sigurinë ose tmerrin, ata e bëjnë edhe më të madhe- e përhapin. Sikur ata t'i drejtohen për këtë Pejgamberit ose përfaqësuesve të tyre, ata do t'i kishin njoftuar."</i> (Kur'ani 4, 83). e) Askush nuk duhet të përbuzë, apo të tallë besimet fetare të të tjerëve, apo të nxisë armiqësi publike kundër tyre; respekti ndaj ndjenjave fetare të të tjerëve është obligim i të gjithë muslimanëve: <i>"Mos i shani ata, të cilëve u luten në vend të All-llahut, se ata do të shajnë All-llahun nga armiqësia, duke mos e ditur. Gjithashtu çdo populli ua kemi zhukuruar veprat e tyre. Ata pastaj do t'i kthehen Zotit të vet. Ai do t'i informojë se çka kanë punuar."</i> (Kur'ani 6, 108).	
Neni 13 - E drejta për lirinë e besimit Çdo person ka të drejtë për lirinë e ndërgjegjës dhe adhurimit, në përputhje me bindjet e tij fetare: <i>"Ju keni fenë tuaj, kurse unë kam fenë time"</i> (Kur'ani 109, 6)	Neni 13- E drejta në mjet efektiv Çdokush, të drejtat e të cilit, ashtu siç janë vënë në këtë Konventë, janë shkelur, duhet të ketë ndonjë mjet efektiv para ndonjë autoriteti kombëtar edhe nëse kjo shkelje është kryer nga persona që kanë vepruar në ndonjë kapacitet zyrtar.
Neni 14-E drejta për shoqërim të lirë Çdo personi, i jepet e drejta për të marrë pjesë individualisht dhe kolektivisht në jetën fetare, sociale, kulturore dhe politike të komunitetit të tij; dhe për të krijuar institucione dhe mjete, që kanë si qëllim të bëjnë atë çfarë është e drejtë (maruf) dhe për të parandaluar çfarë është e ndaluar (munker): <i>"Thuaj: ' Kjo është rruga ime, unë thërras te All-llahu, haptazi, unë dhe kush më pason mua."</i> (Kur'ani 12, 108). Çdo personi i jepet e drejta për t'u përpjekur për themelimin e institucioneve	Neni 14- Ndalimi i diskriminimit Gëzimi i të drejtave dhe lirive të vëna në këtë Konventë do të sigurohet pa diskriminim në çfarëdo baze si gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, opinionin politik ose tjetërfarë, origjina kombëtare ose sociale, lidhja me ndonjë minoritet kombëtar, prona, lindja ose ndonjë status tjetër.

ku zotërimi i këtyre të drejtave duhet të bëhet i mundur. Kolektivisht, komuniteti është i obliguar për të krijuar kushte të tilla, që u lejojnë antarëve të tij të zhvillojnë plotësisht personalitetet e tyre: *"Dhe le të ketë nga ju të atillë që do të thërrasin në të mirë dhe kërkojnë të bëhen punë të mira dhe të pengojnë nga veprat e këqia."* (Kur'an 3, 104); *"Ndihmoheni njëri-tjetrit në hamirësi dhe devotshmëri dhe mos ndihmoni në mëkat dhe armiqësi!"* (Kur'ani 5, 2); *"Nëse dikush sheh dikënd që bënë padrejtësi dhe nuk e ndalon atë nga një gjë e tillë, ai shumë shpejtë do të jetë i dënuar nga Zoti"* (hadithi sipas Ebu Davudit, Tirmidhiut, Nesaiut dhe Ibn maxhes.

Neni 15- Rendi ekonomik dhe të drejtat e evolvimit

a) Në punët e tyre ekonomike, të gjithë personave, u jepet e drejta për përfitime të plota të natyrës dhe të të gjitha burimeve të saj. Ekzistojnë mirësi të dhuruara prej Zotit për të mirën e njerëzimit në tërësi: *"All-llahu i takon pushteti i qiejve dhe i tokës, edhe çka ka në to."* (Kur'ani 5, 120); *"Dhe ua ka nënshtuar çka ka në qiej dhe në tokë. E tëra është prej tij..."* (Kur'ani 45, 13). *"As njerëzve mos ua cenoni të drejtat e tyre dhe mos bëni krime e shkatërrime në tokë"* (Kur'ani 26, 183). *"Se dhuratat e Zotit tënd nuk janë të ndaluara për askë"* (Kur'ani 17, 20)

b) Të gjitha qenieve njerëzore u jepet e drejta për të siguruar jetesën e tyre në përputhje me Ligjin: *"Në tokë nuk ka asnjë qenie të gjallë e të mos e ketë ushqimin te All-llahu"* (Kur'ani 11, 6); *"Ai i cili ua ka bërë tokën të përshtatshme, andaj ecni nëpër te dhe ushqehuni me furnizimet e tij."* (Kur'ani 67, 15).

c) Çdo personi, i jepet e drejta për pronën e vet individualisht, apo në shoqëri me të tjerët. Prona shtetërore e pasurive ekonomike të përcaktuara në interesin

Neni 15 - Derogimi në kohë të emergjencës

1. Në kohë të luftës ose të ndonjë emergjence tjetër publike që kërcënon jetën e kombit, cilado palë e lartë kontraktuese mund të marrë masa që derogojnë nga obligimet e saj sipas kësaj Konvente deri në shkallën rreptësisht të kërkuar nga urgjenca e situatës, me kusht që masat e tilla të mos jenë në mospajtim me obligimet e tjera të saj sipas së drejtës ndërkombëtare.

2. Kurrfarë derogimi nga neni 2, pos në lidhje me vdekjet që rezultojnë nga aktet e ligjshme të luftës, ose nga nenet 3, 4 (paragrafi 1) dhe 7, nuk do të bëhet sipas kësaj dispoziteje.

3. Cilado palë e lartë kontraktuese që përfiton nga kjo e drejtë e derogimit do të mbajë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës plotësisht të informuar për masat që ajo ka marrë dhe për arsyet për këtë. Ajo gjithashtu do të informoj Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës kur masat e tilla kanë pushuar së vepruari dhe kur dispozitat e Konventës po zbatohen

publik është e ligjshme: "Dhe se Ai i pasuron dhe zbukuron " (Kur'ani 53, 48); " Atë që ia ka dhënë All-llahu si plaçkë Pejgamberit të vet nga fshatrat, ajo është e All-llahut, e Pejgamberit, të afërmit dhe bonjakëve të varfënjakëve, dhe udhëtarit që ajo të mos qarkullojë ndërmjet pasanikëve tuaj " (Kur'ani 59, 7).

d) I varfri ka të drejtën e një pjese të paracaktuar në pasurinë e të pasurit, siç përcaktohet prej Zekatit, që obligohet dhe mbledhet në përputhje me Ligjin: "Edhe ata që në pasurinë e tyre kanë një pjesë të caktuar. Për lypsin dhe për atë (nevojtarin) që nuk lyp " (Kur'ani 70, 24-25); "Nëse refuzoni të më jepni vetëm një pjesë të asaj që ia keni dhënë Pejgamberit, do të luftoj kundër jush " (thënia e h. Ebu Bekrit).

e) Të gjitha burimet dhe mjetet e prodhimit duhet të shfrytëzohen në interes të bashkësisë (Ummetit) në tërësi, dhe nuk duhet të mospërfillen apo të shpërdorohen: "Cili nga shërbëtorët e Zotit nuk i ofron ndihmë njerëzve për të cilën është i ngarkuar, nuk do të gjej rrugën e tij për xhenet " (hadithi sipas Buhariut dhe Muslimit).

f) Me qëllim të përkrahjes së zhvillimit të një ekonomie të balancuar dhe të ruajtjes së shoqërisë prej eksploatimit, Ligji Islamik ndalon: monopolet, praktikat tregtare restriktive të paarsyeshme, fajden, të detyruarit në bërjen e kontratave dhe publikimin e reklamimeve mashtruese: "Kush gënjen, nuk është i yni " (hadithi sipas Muslimit); "Pejgamberi ka ndaluar shitjen e gjërave të pavlerë dhe të dyshimta " (hadithi sipas Muslimit, Ebu Davudit, Tirmidhiut dhe Nesaiut); "Pejgamberi ka ndaluar shitjen e rrushit, para se të jetë pjekur dhe shitjen e të lashtave (drithërave) para se të jenë forcuar " (hadithi sipas Buhariut, Muslimit, Ebu Davudit, Tirmidhiut dhe Nesaiut); "Të mjerë ata që

prapë në tërësi.

<i>drejtë nuk peshojnë. Të cilët kur blejnë e marrin masën e plotë prej të tjerëve. Por kur u masin të tjerëve me litër e kandar ua mungojnë</i> "(Kur'ani 83, 1-3); "I'etëm qyqari monopolizon" (hadithi sipas Muslimit); " Mirëpo All-llahu e ka lejuar tregtinë dhe e ka ndaluar kamatën "(Kur'ani 2, 275); " Blerësi dhe shitësi kanë të drejtë të ndërrojnë mendimin, derisa nuk janë ndarë nga njëri tjetri. Nëse ata janë të bashkuar dhe në harmoni atëherë shitblerja do të jetë e bekuar, e nëse mashtrojnë dhe gënjejn atëherë bekimi është larg punës së tyre. " (hadithi sipas Buhariut, Muslimit, Ebu Davudit, Tirmidhiut dhe Nesaiut). Të gjitha aktivitetet ekonomike janë të lejuara me kusht që ato të mos jenë të dëmshme për interesat e bashkësisë (Ummetit) dhe të mos shkelin ligjet dhe vlerat Islame.	
Neni 16-E drejta për mbrojtjen e pronës Prona nuk mund të shpronësohet, përveçse për interes publik dhe mbi pagesën e kompensimit të drejtë dhe të mjaftueshëm: "Dhe mos e hani pasurinë e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar "(Kur'ani 2, 188); "Kush merr nga toka në mënyrë të padrejtë, në Ditën e gjykimit do të zhytet, së bashku me atë tokë, në zjarr. " (hadithi sipas Buhariut); " Atij prej jush që i është besuar ndonjë punë publike dhe ai kompromentohet qoftë edhe sa maja e gjilperës, ai është mashtrues, dhe në Ditën e gjykimit do të ndëshkohet. " (hadithi sipas Muslimit)	Neni 16- Restriksionet në aktivitetin politik të të huajve Asgjë në nenet 10, 11 dhe 14 nuk do të konsiderohet parapengim i palëve të larta kontraktuese nga imponimi i restriksioneve në aktivitetin politik të të huajve.
Neni 17-Statusi dhe dinjiteti i punëtorëve Islami e nderon punën dhe punëtorët dhe i urdhëron Muslimanët, jo vetëm t'a trajtojnë punëtorin me drejtësi, por gjithashtu edhe me bujari. Ai kërkon që jo vetëm t'i paguhet atypëraty paga e tij e fituar me punë, por gjithashtu i jep të drejtën e	Neni 17- Ndalimi i abuzimit të të drejtave Asgjë në këtë Konventë nuk mund të interpretohet si që nënkupton, për cilindo shtet, grup ose person, çfarëdo të drejte që të futet në çfarëdo aktiviteti ose të kryejë çfarëdo akti që ka synim

pushimit të mjaftueshëm dhe të kohës së lirë : " Dhe thuaj: punoni ... "(Kur'ani 9, 105). " Zoti i do ata të cilët punën e tyre e kryejnë në mënyrë të përsosur. "(hadithi sipas Ebu Jula's). "Jepjani mëditësit mëditjen e tij para se t'i thahet djersa e ballit " (hadithi sipas Ibn Mashes)." Për secilin ka shkallë të posaçme sipas asaj që kanë punuar. Vëprat e tyre do t'i shpërblejë dhe ata nuk do të dëmtohen. " (Kur'ani 46, 19); "Dhe thuaj: Punoni! Se All-llahu do ta shoh punën tuaj, por edhe Pejgamberi i tij edhe besimtarët "(Kur'ani 9, 105); "Zoti e do besimtarin zanatçi" (hadithi sipas Taberaniut)." Në Ditën e gjykimit (Zoti thotë) Unë jam kundërshtar i tre personave: njeriut i cili ka premtuar diç në emrin tim, kurse nuk e ka përmushur premtimin; njeriut i cili ia ka shitur tjetrit personin e lirë dhe njeriut i cili ka marrë me qira mëditësin, nga ai ka përfituar çdo gjë që ka dashur, kurse nuk e ka paguar" (hadithi sipas Buhariut).	shkatërrimin e çfarëdo të drejte ose lirie të vënë këtu ose kufizimin e tyre në një shkallë të madhe se që është paraparë në Konventë.
Neni 18-E drejta për sigurim social Çdo person ka të drejtë për t'u ushqyer, për t'u strehuar, për t'u veshur, për t'u edukuar dhe për përkujdesje mjeksore në përputhje me burimet e bashkësisë. Ky obligim i bashkësisë shtrihet në veçanti ndaj të gjithë individëve, të cilët nuk mund të kujdesen për veten e tyre për shkak të disa paafësive, qofshin ato të përkohshme apo të përhershme: "Pejgamberi duhet të jetë më i kujdesshëm ndaj besimtarëve se sa ata ndaj vetës " (Kur'ani 33, 6).	Neni 18- Kufizimi në përdorimin e restriksioneve në të drejta Restriksionet e lejuara sipas kësaj Konventeje në të drejtat dhe liritë e caktuara nuk do të zbatohen për çfarëdo qëllimi tjetër, pos atyre për të cilat ato janë parashkruar.

Neni 19- E drejta për të formuar familje

a) Çdo personi i njihet e drejta të martohet, të krijojë familje dhe të edukojë fëmijët në përputhje me religjionin, traditat dhe kulturën e tij. Çdo bashkëshorti i njihet e drejta e të drejtave dhe privilegjeve të tilla dhe mban obligime sikurse janë parashikuara sipas Ligjit: "*O njerëz, frikësohuni Zotit tuaj, i cili ju krijoi prej një njeriu, nga i cili krijoi edhe shokun e tij për jetë dhe prej atyre dyve bëri shumë meshkuj dhe femra.*" (Kur'ani 4, 1); "*Edhe ato kanë po aq të drejtë sa edhe obligim, por burrat kanë përparësi për një shkallë ndaj tyre.*" (Kur'ani 2, 228); "*Ju jeni përgjegjës dhe do të jepni llogari për ata që keni në ngarkim.*" (hadithi sipas Buhariut, Muslimit, Ebu Davudit, Tirmidhiut dhe Nesaiut).

b) Secilit prej partnerëve në martesë i jepet e drejta për respekt dhe nderim të tjetrit: "*Edhe një tjetër argument i tij është se Ai, nga lloji juaj krijoi bashkëshort që të gjeni prehje pranë tyre dhe ndërmjet jush mbjell dashuri dhe mëshirë.*" (Kur'ani 30, 21).

c) Çdo bashkëshort është i obliguar të mirëmbajë bashkëshorten dhe fëmijët e tij në përputhje me pasurinë e tij: "*Ai që ka, le të shpenzojë sipas pasurisë së vet, por edhe si që është në skamje le të shpenzojë nga ajo që i ka dhënë Allahu, sepse Allahu nuk ngarkon askë më tepër se sa i ka dhënë.*" (Kur'ani 65, 7).

d) Çdo fëmijë ka të drejtë të mirëmbahet dhe të edukohet siç duhet prej prindërve të tij, ndalohet që fëmijët të punojnë në një moshë të hershme, apo që mbi ta të vendoset ndonjë barrë e cila mund të pengojë, apo të dëmtojë zhvillimin e tyre natyral: "*Dhe thuaj: O Zoti im, ki mëshirë ndaj tyre, siç kanë pasur kujdes ata ndaj meje në vegjëli!*" (Kur'ani 17, 24).

e) Nëse prindërit, për disa arsye, janë të paaftë për të plotësuar obligimet e tyre

kundrejt fëmijës, atëherë është përgjegjësi e bashkësisë për të përmbushur këto obligime në llogari të shpenzimeve publike: "*Unë kujdesem për secilin musliman, më shumë se ai për vete. Nëse dikush lë ndonjë borxh ose ndonjë foshnje pa përkujdesje, është obligim imi që unë të përkujdesem për ta. Nëse dikush lë pasuri, atëherë ajo i takon trashëgimtarëve.*" (sipas Buhariut, Muslimit, Ebu Davudit dhe Tirmidhiut.).

f) Çdo personi i jepet e drejta për t'u mbështetur materialisht, si edhe për përkujdesje dhe përkrahje prej familjes së tij gjatë fëmijërisë së tij, në pleqëri apo në rast paafësie. Prindërve u jepet e drejta për t'u përkrahur materialisht si edhe për përkujdesje dhe mbrojtje nga ana e fëmijëve të tyre: "*Ti dhe çka është e jotja është e babait tënd*" (hadithi sipas Ebu Davudit).

g) Amësisë i jepet e drejta për respekt të veçantë, përkujdesje dhe ndihmë nga ana e familjes dhe organeve publike të bashkësisë (Ummetit): "*O i Dërguar, kush e meriton më së shumti respektin tim? Ai u përgjigj: Nëna jote! Ai përsëri pyeti: E pas asaj? Ai u përgjigj: Nëna jote! Ai pyeti përsëri: pas asaj? Ai u përgjigj: Nëna jote! Ai pyeti edhe një herë: E pas asaj? Ai u përgjigj: Babai yt!*" (sipas Buhariut dhe Muslimit).

h) Brenda familjes, burri dhe gruaja kanë pjesë në obligimet dhe përgjegjësitë e tyre sipas gjinisë së tyre, dhuntive të tyre natyrore, talenteve dhe prirjeve, duke mos harruar përgjegjësitë e tyre të përbashkëta kundrejt pasardhësve të tyre dhe farefisit të tyre: "*O i Dërguari i Zotit, kë duhet ta respektoj më shumë? Ai përgjigjet: Nënë tënde, pastaj nënë tënde, pastaj përsëri nënë tënde, pastaj babain tënd, pastaj kushërirët, pastaj kushërirët.*" (hadithi sipas Ebu Davudit dhe Tirmidhiut).

i) Asnjë person nuk duhet të martohet kundër dëshirës së tij apo të saj, apo të

humbasë, apo të pësojë uljen e personalitetit të ligjshëm për shkak martesës: <i>"Një vajzë erdhi tek i Dërguari dhe i tregoi se i ati e kishte fejuar, edhe pse ajo kishte refuzuar një gjë të tillë. Pejgamberi i lejoj asaj të vendos. "(hadithi sipas Ahmedit dhe Ebu Davudit).</i>	
Neni 20- Të drejtat e grave të martuara Çdo gruaje të martuar i jepet e drejta që: a) të jetojë në shtëpinë në të cilën jeton burri i saj: <i>"Le të banojnë ku banoni edhe ju" (Kur'ani 65, 6).</i> b) të pranojë pasurinë e nevojshme për mbajtjen e një standardi jetese, që nuk është më i ulët se ai i burrit të saj, dhe në rast divorci të marrë gjatë periudhës së përcaktuar të pritjes (idet) pasuri për të jetuar në përpjestim të drejtë me pasurinë e burrit të saj për vetveten si edhe për fëmijët që ajo kujdeset apo që i mban, pavarësisht prej gjendjes së saj financiare, pagës, apo pasurisë që mund të zotërojë: <i>"Burrat janë mbështetje e grave me atë sa u ka dhënë Allahu përparësi njëres pulë ndaj tjetrës dhe për shkak se ata shpenzojnë pasurinë e vet " (Kur'ani 4, 34); " Nëse janë me harrë ju furnizoni deri sa të lindin " (Kur'ani 65, 6); " E nëse ju japin gjë fëmijëve tuaj, atëhere atyre jepuni shpërblimin e vet" (Kur'ani 65, 6).</i> c) të kërkojë dhe të fitojë prishjen e martesës në përputhje me kushtet e Ligjit. Kjo e drejtë i takon asaj, përveç të drejtës së saj për të kërkuar divorc nëpërmjet procedurave gjyqësore: <i>"Po nëse frikësoheni se ata dy nuk do të mund t'i ruajnë dispozitat e Allahut (në bashkëshortësi), nuk e kan mëkat atë (divorcin) me atë që ajo bënë kompensim" (Kur'ani 2, 229).</i> d) të trashëgojë prej burrit të saj, prindërve të saj, fëmijëve të saj dhe të afërmeve të	

tjerë, në përputhje me Ligjin: "Kurse bashkëshorteve u takon një e katërta nga ajo që lini ju, nëse nuk keni fëmijë; e në qoftë se keni fëmijë atyre u takon një e teta nga ajo që keni lënë ju " (Kur'ani 4, 12). e) Besueshmëri strikte prej bashkëshortit të saj, apo ish-bashkëshortit nëse është divorcuar, në lidhje me ndonjë informacion që ai mund të ketë siguruar rreth saj, përhapja e të cilit mund të rezultojë i dëmshëm për interesat e saj. Një përgjegjësi e njëjtë qëndron edhe mbi të, përsa i përket bashkëshortit, apo ish-bashkëshortit të saj: "Dhe mos harroni mirësinë ndaj njëritjetrit" (Kur'ani 2, 237).	
Neni 21- E drejta për t'u arsimuar a. Çdo personi i njihet e drejta për t'u arsimuar në përputhje me aftësitë e tij natyrore: "Zoti yt ka përcaktuar që të mos adhuronit tjetër përveç Atij dhe të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre, ose të dy, përfetojnë pleqëri te ti, mos u thuaj 'of!' e as mos u fol me zë të lartë, por t'u drejtohesh me fjalë respekti të plotë. Shtrij përpara tyre krahët e përrulshmërisë dhe thuaj: 'O Zoti im, ki mëshirë ndaj tyre, siç kanë pasur kujdes ata ndaj meje në vegjëli'" (Kur'ani 17, 23-24).: "Të kërkuarit e dijes është obligim për çdo musliman dhe muslimane " (hadithi sipas Ibn Maxhes). b. Çdo personi i njihet e drejta për një zgjidhje të lirë të profesionit dhe karrieres dhe mundësisë për zhvillimin e plotë të dhuntive të tij natyrore: "Dhe kur All-llahu e mori besën prej atyre të cilëve u është dhënë Libri, se me siguri do t'ua sqarojnë njerëzve dhe nga ai nuk do të fshihin asgjë, ata pastaj e lanë këtë pas shpine (Librin) dhe patën blerë me të diçka që vlen fort pak. Sa e keqe është ajo çka kanë blerë ata!" (Kur'ani 3, 187); " Atij që Zoti ia do të mirën , ia mëson fenë, ndërkaq, unë jam vetëm ai që ndan, kurse Zoti jep " (sipas	

Buhariut dhe Muslimit); " Secili është i suksesshëm kur kryen atë për çka është i krijuar ".(sipas Buhariut, Muslimit, Ebu Davudit dhe Tirmidhiut).	
Neni 22- E drejta për ruajtjen e sferës private Çdo personi i njihet e drejta për të mbrojtur jetën e tij private: "<i>A ia ke hapur zemrën</i>" (hadithi sipas Muslimit); "<i>Dhe mos spiunoni njëri-tjetrin</i> " (Kur'ani 49, 12); "<i>O ju, që jeni bërë Musliman vetëm me gjuhë, dhe që feja nuk ju ka depërtuar në zemra: mos i shkaktoni muslimanëve hidhërim, mos i spiunoni dhe mos shfrytëzoni pikat e tyre të dobëta. Kush ia zbulon të metat muslimanit, Allahu do t'ia zbuloj atij të metat në botën tjetër.</i>" (hadithi sipas Ebu Davudit dhe Tirmidhiut).	
Neni 23- E drejta për lirinë e lëvizjes dhe vendbanimit a) Duke marrë parasysh faktin se Bota Islame është vërtet një Bashkësi Islame (Umma Islammije), çdo Musliman ka të drejtë të lëvizë lirisht brenda dhe jashtë çdo vendi Musliman: "<i>Ai i cili ua ka bërë tokën të përshatshme, andaj ecni nëpër te dhe ushqehuni me furnizimet e tij</i> " (Kur'ani 67, 15); "<i>Thuaj: ' Ecni nëpër tokë e shihni se si kanë përfunduar përgënjeshtarët</i>".(Kur'ani 6, 11); "<i>Vallë, a nuk ishte toka e All-llahut e gjërë që të emigroni</i>" Kur'ani 4, 97). b) Askush nuk duhet të detyrohet forcërisht ta lëshojë vendbanimin e tij apo të internohet arbitrarisht, pa kërkuar ndihmën e procedurës gjyqësore: "<i>Të pyesin për muajin e shenjtë, për luftën në të. Thuaj, luftimi në atë muaj është mëkat i madh, por shmangia nga rruga e Allahut dhe mohimi i tij dhe tempullit të shenjtë dhe përçënia e</i>	

<i>hanorëve të tij prej aty, është mëkat më i madh te All-llahu " (Kur'ani 2, 217); "edhe ata të cilët e kanë përgatitur shtëpinë dhe besimin, përpara atyre, i duan ata që kanë urdhur te këta dhe nuk ndiejnë ngushti në zemrat e tyre ndaj asuj që u është dhënë atyre, dhe u japin përparësi, madje edhe kur kanë nevojë për vete." (Kur'ani 59, 9).</i>	
Përfundimi i dokumentit. <i>Falenderimi i takon Allahut, Zotit të gjitha botrave.</i>	

Dallimet midis Deklaratës Islame dhe Konventës Evropiane

Deklarata Islame dhe Konventa Evropiane përmbajnë 10 të drejtat fundamentale, të cilat në esencë i takojnë grupit të të drejtave dhe lirive tradicionale civile e politike, që janë paraparë edhe në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, të cilat kanë të bëjnë me të drejtat civile dhe politike.¹⁹

Në Deklaratën Islame dhe në Konventën Evropiane çdokujt i garantohet: dinjiteti dhe siguria personale; liria nga skllavërimi ose nga gjendja e ngjashme me skllavërimin; liria nga burgimi arbitrar, paraburgimi ose përjashtimi; liria nga ndërhyrja arbitrarë në jetën private dhe në familje, banesë dhe korrespondencë; liria e besimit, e bindjes dhe e fesë; liria e mendimit, e fjalës dhe e të shprehurit; liria e tubimit; liria e bashkimit, duke përfshirë edhe krijimin dhe hyrjen në sindikata, si dhe liria e martesës dhe e themelimit të familjes. Deklarata, në nenin 3, dhe Konventa, në nenin 14, parashohin se liritë dhe të drejtat duhet t'u njihen të gjithëve, pa dallim në bazë të fesë, bindjes politike, gjuhës, racës, seksit, ngjyrës, origjinës kombëtare ose sociale, pasurisë etj.²⁰

Kur'ani urdhëron drejtësi absolute: dënon çdo diskriminim për shkak të fesë, nacionalitetit, ngjyrës, fëfëfisnisë apo për arsye armiqësie. Vendimet duhet të sillen me drejtësi, qoftë edhe nëse shkojnë në favor të armikut, apo në dëm të fëfëfisnisë. Drejtësia sipas Islamit, nuk lejon kurrfarë diskriminimi, cildo qoftë dallimi në mes

¹⁹ Krahajo me Deklaratën Universale e të Drejtave të Njeriut. KSIH (Botim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit). Albinform. Tiranë. Qershor. 1994. & Pakti Nërkombëtar lidhur me të drejtat civile dhe politike. Botim i KSIH. Albinform. Tiranë. Qershor 1994.

²⁰ Shih Dr. Vehbe ez Zuhejli. Hakul hurrijeti fil alem. Damask. 1421/ 2000. f. 34-35. dhe Revista. Rabitatul Alemil Islami. Hukukul Insani fil Islam. Mekë. 1979. f. 102-103.

dy palëve kundërshtuese. Kjo do të thotë se Kur'ani nuk lejon në asnjë rast, pavarësisht nga ndryshimi i rrethanave dhe motivit, që të zhvleftësohet parimi i drejtësisë në kuadër të normave kuranore, dhe që në vend të drejtësisë të aplikohet parimi i dhunës.

Një nga parimet e përgjithshme të Kur'anit është, gjithashtu, proklamimi i dinjitetit njerëzor për të gjithë njerëzit, pavarësisht nga prejardhja ose pozita, mbështetur vetëm në devotshmëri.

Kur'ani proklamon se gjithë njerëzimi përbën një familje, se të gjithë njerëzit janë prej një babe dhe prej një nëne, se kanë vetëm një Zot. Ai na mëson se All-llahu, njerëzit i ka bërë në popuj dhe fise që të njihen dhe të bashkëpunojnë në çdo gjë që është e mirë dhe e dobishme; që të mos jenë armik i njëri-tjetrit; të mos urrejnë njëri-tjetrin dhe të mos i bëjnë padrejtësi njëri-tjetrit. Edhe me këtë rast Kur'ani nuk pranon që në çfarëdo kushte dhe rrethana të shkelet ky parim i njëshmërisë së familjes njerëzore. Ai rekomandon, në bazë të njohjes reciproke, bashkëpunimin dhe barazi të askush s'mund të dale e të vendosë në vend të parimit të përmendur, parimin e padrejtë të racizmit. Pra, të qenurit e Kur'anit akt normative hyjnor i drejtësisë, do të thotë se parimet e tij të përgjithshme janë ata, që sipas dijes, arsyes dhe të menduarit, nuk mund të ndryshohen ose të kenë alternativë. Kjo do të thotë se qoftë parimet e përgjithshme, qoftë e drejta islame me dispozitat e saja të veçanta të së drejtës civile, penale dhe të drejtës familjare të bazuara në Kur'an, janë brenda dijes, arsyes, të menduarit dhe interesit të përgjithshëm.

Islamic Declaration on Human Rights and European Convention Human rights in Islam

Summary

The Almighty Allah states in the Glorious Qur'ân Sura al-Hujurat, (The Chambers), 49:13 the meaning of which is translated as: “***Oh Mankind! We created you from a single (pair) of a male and a female, and made you into nations and tribes, that you may know each other (not that you may despise each other). Verily the most honored of you in the Sight of Allah is (he who is) the most righteous of you. And Allah has full Knowledge and is well-acquainted (with all things)***”.

The entire humanity constitutes as one big family. They are united under the banner of all being slave servants to Allah and they are the children of Adam (peace and blessings of Allah be upon him), the Prophet. All people are equal in terms of human dignity and honor. All people are also equal in terms of responsibility. No race, color, language, sex, religious belief, political belonging, social status or any other serves as a factor that differentiates them. The true and sound belief is the only assurance and guarantees to ensure the growth of this human integrity for the human integration.

This is a comparative study between Islamic Law and European Law. Law is a basic constituent of Islam. By law we mean a set of rules, principles and laws (given by Allah in the Qur'an and by his Messenger in his traditions) that regulate human interrelations in all aspects of life and indicate to people what Allah likes to do and what to leave off.

There are things that Islamic law deals with in specific terms. However, there are other things which are dealt with in rather general terms or even left off.

Islamic Legislation leaves a vacant area on purpose, which we call the area of Allah's favour or tolerance, using the Prophet's word. This vacant area, in terms of law, signifies Allah's kindness, mercy to and even provision for His creatures.

A close look into this area will indicate that it includes the issues which are conditioned by factors of specific time, environment, stage of development, political and military circumstances etc.

At times Islamic law provides only general principles or guide lines and leaves the detail for every people and or generation to decide in the light of what is good and convenient for them.

Islamic law is decisively specific in stable matters which change only under very special circumstances such as family matters and inheritance or estate. This unmistakable specificity is meant to clear all confusion, as All-llah informs us in respect to the matters of estate: "God expounds for you, so that you do not fail error, and God has knowledge of all things (4:176). So that you not be misled and go astray.

The pure monotheistic faith, on which Islam is built, is the one that built the real foundation of people's freedom, dignity and integrity and declared the freedom of man from the slavery of another man.

In recognition to the human efforts related to the human rights that protect man against mistreatment, violation and abuse and with aim to emphasize man's freedom and his right to a better and descent life and living conditions these should agree with the Islamic Shari'ah.

We believe, according to Islam, that the basic rights and public freedoms are an integral part of the Islamic belief and religion. None has the right, initially, to stop them fully or partially. We also believe that none has the right either to break these rights or ignore them. These basic rights are divine and heavenly. They have been revealed to the Prophets of Allah in all Scriptures.

Meanwhile, neglecting such rights or infringing them is an evil act, according to Islam. Every individual is responsible, individually, to adhere to these rights. The Ummah, collectively, is also responsible for these rights.

These rights are sufficient to establish a society that grants its individuals a decent and honorable life. These rights are a mercy from the Almighty Allah, the Lord of all worlds and they are for the entire humanity at large. Human rights also serve to preserve political, social, moral and economic rights of humanity.

